

Në Kongresin e 6-të të Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë morën pjesë delegacione nga Europa dhe SHBA. Kongresin e përshëndetën Konfederata Botërore e Sindikatave, AFL-CIO-s amerikane, Solidarnosc Poloni, BSP Kosovë dhe drejtuesit e sindikatave të rajonit. Gjithashtu Kryetari i PD Lulzim Basha

Kongresi i 6-të i BSPSH-së, i zhvilloi punimet më 6-7 Shtator 2014. Të shoqëruar nga “Marshi i Triumfit”, flamurtarët vendosën në tribunën qendrore flamujt e federatave duke shënuar kështu fillimin e punimeve të Kongresin të VI-të, të Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë. Pas shfaqes së dokumentarit mbi historikun e BSPSH-së, moderatori i dha fjalën z. Imir Kambo i cili është një nga nismëtarët për krijimin e BSPSH-së. Pas kësaj fjale përshëndetëse, Presidenti i BSPSH z. Gëzim Kalaja ftoi presidiumin për drejtimin e seancës së parë. Pas ekzekutimit të “Himnit Kombëtar” u deklarua pjesëmarrja nga Kryetari i Komisionit të verifikimit të mandateve. Në këtë kongres morën pjesë 393 delegatë, nga 400 delegatë të mandatuar, të cilët përfaqësonin të gjitha strukturat profesionale dhe rajonale të vendit. Ndryshe nga kongreset e kaluara, mbi 30 % të delegatëve pjesëmarrës të këtij kongresi, e përbënin gratë dhe të rinjtë. Presidenti i BSPSH prezantoi programin e punimeve të Kongresit dhe kërkoi miratimin e komisionit të votimit, dhe të sekretarisë së Kongresit. Në Kongres morën pjesë delegacione nga vende të ndryshme të Europës dhe nga SHBA. Mori pjesë dhe e nderoi Kongresin e VI-të, Enisa Salimovic **PERC/ITUC**, Rudy Porter **AFL-CIO** amerikane, Bogdan Bis Zv/ President, Robert Swewczy

Solidarnosc

Poloni, Mahmut Arslan, Merita Jegeni Yilldiz

HAK-IS

Turqi, Haxhi Arifi, Alush Sejdiu

BSPK

Kosovë, Slobodan Antovski, Divna Zmejkovska

UNASM

Maqedoni, Stefano Mastrovincenzo, Fausto Mazzieri

CISL

Itali, Antonio Morandi

CGIL Nazionale

Itali, Fotiod Koleventis Zv/ President, Kyriaki Psarogiani

GSEE

Greqi. Gjithashtu Kongresin e nderoi me pjesëmarrjen e tij,

Kryetari i PD, z. Lulzim Basha

[RAPORTI I PRESIDENTIT GËZIM KALAJA NË KONGRESIN E 6-të TË BASHKIMIT TË SINDIKATAVE TË PAVARURA TË SHQIPËRISË](#)

Foto nga Kongresi i 6-te i BSPSH









